



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1103/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e Emrane Krendali, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Rahovecit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Rahovec, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1103/2021, i paraqitur nga Emrane Krendali, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Rahovecit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Rahovec, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin ka kërkuar rinumërim e fletëvotimeve në vendvotimin 1626a/06r.

A r s y e t i m

Me datë 04.11.2021, PZAP-i, me datë 08.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1103/2021 (përmes postës më datë 04.11.2021), nga Emrane Krendali, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Rahovecit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Rahovec, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me të cilin pretendon se pas numërimit të votave nga KKZ në Rahovec i ka ditur 100 vota sipas formularit PDF, ku dhe personalisht sipas saj i ka numëruar dhe kjo mund të argumentohet në bazë të formularëve që gjinden në zyrat e subjektit politik PDK në Rahovec. Më tej parashtresja në apel shton se pas rinumërimit të votave në Qendra e Numërimit dhe Rezultateve-Fushë Kosovë, në vendvotimin 1626a/0R, nga 30 vota sa kishte fituar, numri i tyre kishte rënë në 20 pa asnjë argument.

Kërkon që të rinumërohen votat në Vendvotimin 1626a/0R.

Si dëshmi në apel nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin, si dhe shkresat e lëndës vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, në bazë të të cilave ka kërkuar rinumërim të fletëvotimeve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të parashtrueses së apelit gjatë numërimit të votave, për faktin se thënie e saj nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultat përfundimtar, si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1103/2021 më datën 09.11.2021

Kryesuese e Panelit

Burim Ademi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

